

VENDIM
Nr.144, datë 30.12.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E KOHËZGJATJES PËR FATURIMIN AFORFE, PËR
KLIENTËT FAMILJARË PA MATËS TË ENERGJISE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 52 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “OSSH” sh.a. për kohëzgjatjen e faturimit aforfe të energjisë elektrike në abonentët familjarë pa aparat matës të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Afati i aplikimit të faturimit aforfe për klientët familjarë të energjise elektrike, që nuk janë të pajisur me matës, të jetë deri në 31.12.2009.
2. Sasia e energjisë elektrike e faturimit aforfe, për klientët familjarë pa matës të energjisë elektrike (ndarë sipas rretheve) do të jetë e njëjtë me përcaktimet e tabelës sipas vendimit nr.12, datë 28.1.2008.
3. Ky afat i aplikimit të faturimit aforfe për klientët familjarë që nuk janë të pajisur me matës të energjisë elektrike, shtohet në licencën e aktivitetit të shpërndarjes, të dhënë OSSH sh.a. s.,pas vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.114, datë 1.10.2008.
4. Ngarkohet OSSH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta